



KEQADMINISTRIMI I SISTEMIT PROKURORIAL



Autor: Lavdim Makshana

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përkrahur nga:

Prill, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Progresi dhe regresi në miratimin e legjislacionit sekondar	5
3. Llogaridhënia dhe integriteti i sistemit prokurorial.....	7
4. Transparenca e KPK-së dhe sistemit prokurorial.....	8
4.1. (Mos) respektimi i dy gjuhësisë në publikimin e vendimeve	10
5. (Mos) Përmbushja e planit të punës	11
6. Betejat e fituara ligjore të IKD-së për transparencë ndaj Sistemit Prokurorial	12
6.1. Fletëpoentimet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit	12
6.2. Aktvendimet për hudhjen e kallëzimeve penale dhe pushimet e hetimeve	12
7. (Jo) transparenca e kryesuesit Maloku për mediat dhe publikun	13
8. Dështimi i mekanizmave të llogaridhënies në KPK.....	14
8.1. Dështimi i KPK-së në adresimin e përgjegjësisë disiplinore në rastin e vrasjes së S.M	14
8.2. Rasti i dhunimit të 11 vjeçares dhe rasti i vrasjes së S.D	15
9. Integriteti i kontestuar i procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit	17
10. Reagimi jo adekuat i KPK-së ndaj Qeverisë	19
11. Kërcënimet e KPK-së me mos zbatim të ligjit.....	20
12. Sfidat e KPK-së me buxhetin	22
13. (Pa) Barazia Gjinore në Sistemin Prokurorial.....	23

1. Përmbledhja ekzekutive

Kanë kaluar afro katër (4) vite dhe ngjashëm sikurse viteve të kaluara edhe gjatë vitit 2022, KPK ka vazhduar “*avazin e vjetër*” duke dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore për miratimin e akteve që rrjedhin si obligim nga Ligji i ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Gjatë vitit 2022, shumica e rasteve disiplinore ndaj prokurorëve në KPK kanë përfunduar me masa të buta disiplinore si vërejtje publike dhe jo publike me shkrim. Gjatë kësaj kohe, KPK kishte përfunduar me sukses procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve. Këshilli ka dështuar në ushtrimin e kontrollit ndaj krerëve të Prokurorive përmes raportimit të tyre para anëtarëve të saj dhe është mjaftuar vetëm me dorëzimin e raporteve me shkrim.

Mungesë të transparencës sistemi prokurorial ka treguar në raport me kërkesat për qasje në dokumente publike të IKD-së, ku vetëm 50% e kërkesave kanë qenë përgjigje pozitive. Afro gjysmën e vendimeve të miratuara KPK nuk i ka publikuar në faqen e saj zyrtare, po ashtu e njëjta ka vazhduar të mos publikojë në tërësi vendimet e miratuara edhe në gjuhën serbe.

Qasje jo transparente KPK ka treguar edhe kur ka injoruar ofertën e Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit. Në kuptim të ngritjes së transparencës IKD gjatë vitit 2022 përmes Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) ka fituar dy beteja ligjore ndaj KPK-së, njëra për qasje në fletëpoentimet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit e tjetra për qasje në vendimet për hudhje të kallëzimeve penale dhe pushime të hetimeve.


Janë bërë dy vite që prej kur Jetish Maloku është zgjedhur kundërligjshëm si kryesues i KPK-së, i njëjti vazhdimisht kishte proklamuar transparencë para publikut, mirëpo Maloku përveç konferencës vjetore, ai është paraqitur edhe vetëm në një intervistë për vitin 2022. Në vitin 2022 ishte zhvilluar njëri nga proceset më të rëndësishme në sistemin prokurorial, ai i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit, mirëpo sipas koalicionit të OJQ-ve, KPK në këtë proces nuk ka siguruar meritokraci, objektivitet dhe se kandidatët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Në këtë drejtim, IKD rithekson nevojën që Kryeprokurori i Shtetit të dalë nga një proces i cili ka integritet të pakontestuar.

KPK gjatë vitit 2022 ka dështuar të përmbush obligimet për realizimin e plotë të Planit të Punës, që për pasojë ka sjellë ngeljen e një sërë objektivave të pa përmbushura. Në anën tjetër, IKD ka gjetur se mbi 90% e pozitive udhëheqëse në sistemin prokurorial udhëhiqen nga prokurorët e gjinisë mashkullore.

Ndaj vendimit të Qeverisë për ulje të pagave, IKD konsideron se KPK është dashur ti ndjek rrugët ligjore qysh në fillim e jo të bëhet pezullimi i punës pasi ky veprim i KPK-së ka shkuar në dëm të qytetarëve. Deklarimi i KPK-së se nuk do ta respektojë ligjin e ri për KPK janë deklarime skandaloze që nuk duhet të ndodhin në një rend të mirëfilltë juridik.

2. Progresi dhe regresi në miratimin e legjislacionit sekondar

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) gjatë vitit 2022 nuk ka treguar efikasitet të lartë në miratimin e akteve sekondare në krahasim me dy vitet paraprake, konkretisht me vitin 2020 dhe 2021¹, pasi gjatë kësaj periudhe ka miratuar vetëm katër (4) rregullore², katër (4) udhëzues³ dhe një Udhëzim Administrativ (UA)⁴.



Grafiku 1: Miratimi i akteve nënligjore nga KPK 2020-2022

Fenomeni negativ që e ka shoqëruar KPK-në edhe gjatë vitit 2022 ka qenë dështimi për të miratuar aktet nënligjore të përcaktuara me Planin e saj të Punës për këtë vit, si 1) Rregulloren për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e KPK-së, 2) Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit dhe 3) Rregulloren për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve në

¹ **Shënim:** Në komentet e KPK-së (6 prill 2023) për këtë Raport, theksohet arsyeja e regresit në miratimin e akteve, ku ndër të tjera thuhet se: “Krahasimi i nxjerrjes së akteve nënligjore gjatë viteve paraprake, konkretisht të vitit 2020 dhe 2021, vite këto, në të cilat rezultoi të ketë pasur një numër më të madh të akteve të nxjerra, është e tillë për arsye se në vitin 2019 është bërë ndryshimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka obliguar Këshillin për nxjerrjen e akteve në harmoni me ligjin e ri, ndërsa ato që nuk kanë qenë në kundërshtim kanë mundur të zbatohen. Në vitin monitorues nga ana juaj për vitin 2022, shumë akte nënligjore kanë qenë tashmë të miratuara në harmoni me ligjin. Kjo është arsyeja e rënies së numrit të akteve nënligjore në vitin 2022”.

² Rregullore Nr. 01/2022, Nr.02/2022, Nr.03/2022, Nr.04/2022.

³ Udhëzuesi Themelor i Referimit për organet para hetuese dhe hetuese disiplinore, Udhëzues me rregullat e testit kualifikues për kandidatët për prokuror të shtetit, Udhëzues për zbatimin e rregulloreve për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, nr.1104.2022 dhe Udhëzuesi me rregullat e testit me shkrim për kandidatët për prokurorë të shtetit.

⁴ Udhëzim Administrativ Nr.01.2022 për Vulat dhe Simbolet në Sistemin Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Institucionin e Prokurorit të Shtetit.⁵ Po ashtu, KPK gjatë vitit 2022 nuk ka miratuar 4) udhëzuesin për unifikimin e çmimeve të ekspertizave për gjithë sistemin prokurorial.⁶

Po ashtu, KPK edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar “*avazin e vjetër*” pra nuk ka arritur që të miratoj as aktet nënligjore që rrjedhin sipas ligjit të ri për KPK-në, ndonëse kanë kaluar afro katër vite nga hyrja në fuqi e këtij ligji.⁷ Ligji për KPK i cili ka hyrë në fuqi më 18 prill 2019 kishte përcaktuar shprehimisht nxjerrjen e një numri të caktuar të rregulloresh brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi si: *Rregulloren për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përherëshme për KPK-në, Rregulloren për Procesin e Emërimit dhe Riemërimit të Prokurorëve nga Komunitetet e nën-përfaqësuar në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë dhe Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funksonimin e SKPK-së*. Mos zbatimin e këtyre obligimeve ligjore KPK e ka arsyetuar me faktin se janë në fuqi rregullore që rregullojnë çështjet e lartcekura. KPK ka njoftuar se së shpejti pritet që të miratohet Rregullorja për strukturën organizative dhe funksionimin e SKPK⁸.

IKD sikurse vitet e kaluara ia rithekson dhe ia rikujton KPK-së se rregulloret që në fjalë janë akte nënligjore që para së gjithash janë nxjerrë në bazë të një ligji i cili tashmë është shfuqizuar. Në këtë drejtim, rregulloret që përmend KPK duhet të zbatohen vetëm deri në momentin e miratimit të akteve të tjera, të cilat sipas ligjit duhet të miratohen brenda gjashtë (6) muajve që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.06/l-056 për KPK.⁹

IKD rithekson se një ndër obligimet primare të KPK-së është miratimi i akteve nënligjore dhe se secila mungesë e rregullores, paraqet zbrazëtimë juridike. Andaj, është e domosdoshme që KPK nëpërmjet Komisionit për Çështje Normative të zbatojë në tërësi listën e obligimeve që duhen përmbushur. Në kuptim të zbatimit të obligimeve të përcaktuara me ligj, është e domosdoshme që të shmanget praktika negative e deritashme ku ligjet që kanë obliguar KPK-në do të shfuqizoheshin, derisa obligimet që kanë rrjedhur nga to do të mbesin të pazbatuara nga ky institucion.¹⁰

⁵ **Shënim:** Në komentet e dhëna të KPK-së për IKD më 6 prill 2023, KPK thekson se: “*arsyeja përse nuk janë miratuar në Këshill është për shkak, siç keni qenë edhe juve në dijeni, se kemi qenë në procesin e ndryshimeve ligjore, përkatësisht të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, ligje këto, që i afektojnë direkt këto akte nënligjore*”,

⁶ Ky udhëzues është paraparë me Rregulloren 15/2015 për emërimin e ekspertëve gjyqësor.

⁷ **Shënim:** Ligji Nr. 06/L-056 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

⁸ Përgjigjie e KPK-së për IKD. 11 janar dhe 2 shkurt 2023.

Shënim: *Kujtojmë se për këtë të fundit KPK edhe gjatë vitit 2022 kishte thënë se pritej të miratohej, por që deri më tani nuk është arritur të miratohet.*

⁹ Ligji nr. 06/l-056 për KPK. Neni 37.1 “Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”

¹⁰ Bajraktari, L. Gashi, L. “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill 2021. Fq.36-39. Makshana, L. Thaqi, M: “*Administrimi i Sistemit të Drejtësisë nga Këshillat*”. Prishtinë. Qershor 2022. Fq.18

3. Llogaridhënia dhe integriteti i sistemit prokurorial

Shumica e rasteve disiplinore ndaj prokurorëve në KPK gjatë vitit 2022 kanë përfunduar me masa të buta disiplinore si vërejtje publike dhe vërejtje jo publike me shkrim. Gjatë vitit 2022, KPK ka pranuar nëntë (9) kërkesa për inicim të procedurave disiplinore, nga të cilat janë themeluar tetë (8) panele hetimore, ndërsa një (1) kërkesë për inicim të procedurës është refuzuar nga KPK. Në tetë raste disiplinore KPK ka nxjerrë tetë (8) vendime disiplinore, prej nga masa më e rëndë e shqiptuar është transferimi i përhershëm i një prokurori në një Prokurori tjetër.

Në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore duhet theksuar se KPK dhe Prokurori i Shtetit (PSH) kanë miratuar raportet vjetore të punës për vitin 2021 dhe të njëjtat edhe i kanë publikuar në ueb-faqen zyrtare. Mirëpo, ashtu siç ka ndodhur në vitet e kaluara, edhe për këtë vit këto raporte përmbajnë vetëm të dhëna të shumta statistikore, por që nuk ndërtojnë një analizë konkrete lidhur me këto të dhëna statistikore. KPK sikurse vitin 2021, edhe gjatë kësaj periudhe kishte përfunduar me sukses procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve.

Raportimi para Këshillit të Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse është një ndër mekanizmat më të rëndësishëm të kontrollit të KPK-së. Përmes këtij mekanizmi, KPK mbanë përgjegjës dhe monitoron funksionimin e Prokurorive. Kjo i mundëson KPK që në mënyrë adekuate të ushtrojë kompetencat që ka. Përkundër kësaj, gjatë vitit 2022, KPK ka dështuar ta implementojë këtë mekanizëm.

Kryeprokurorët e Prokurorive përkatëse kanë raportuar para anëtarëve të KPK-së vetëm për tre mujorin e parë të vitit 2022.¹¹ KPK nuk ka dhënë ndonjë arsytim se pse Kryeprokurorët nuk kanë raportuar para anëtarëve të saj, por sipas KPK-së, Kryeprokurorët kanë raportuar për tre (3) mujorët e vitit 2022 me shkrim.¹² Kjo formë e raportimit, pa u sfiduar nga anëtarët e KPK-së, nuk paraqet raportim real të kryeprokurorëve, por vetëm përmbushje formale të këtij obligimi.

Anëtarët e KPK-së në mungesë të kryeprokurorëve kishin vendosur ta shtynin raportimin për një takim tjetër ku shqetësime ishin ngritur nga anëtari i KPK-së Armend Zenelaj, i cili kishte thënë se kryeprokurorët duhet të jenë vetë në takim që ti prezantojnë raportet e tyre e jo vetëm ti dërgojë ato me shkrim. Mos prezenca e kryeprokurorëve gjatë prezantimit të raporteve të punës i ka pamundësuar anëtarëve të KPK-së që të kërkojnë sqarime shtesë apo të marrin përgjigje nga të njëjtit për të dhëna të caktuara që i përmbajnë ato plane pune.

Raportimi i Kryeprokurorëve vetëm me shkrim, pa u sfiduar nga anëtarët e KPK, nuk paraqet raportim real të kryeprokurorëve, por vetëm përmbushje formale të këtij obligimi. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se është e domosdoshme që miratimi i këtyre raporteve të mos shndërrohet vetëm në përmbushje formale të obligimeve, por që t'i mundësohet anëtarëve të KPK që të

¹¹ “Kryeprokurorët raportojnë për periudhën janar–mars 2022 në Këshillin Prokurorial”. Betimi për Drejtësi. 17 maj 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtësi.com/kryeprokuroret-raportojne-per-periudhen-janar-mars-2022-ne-keshillin-prokurorial/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2023).


¹² Përgjigje e KPK-së për IKD. 21 shkurt 2023.

mbajnë përgjegjës kryeprokurorët dhe ti mundësojë publikut të gjerë që të mirë informohet për punën dhe sfidat reale të sistemit prokurorial.

4. Transparenca e KPK-së dhe sistemit prokurorial

KPK vazhdimisht proklamon ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Për këtë qëllim, KPK ka miratuar edhe rregullore¹³ dhe strategji¹⁴. Kjo është shprehur edhe në Plan vjetor të Punës.¹⁵ Mirëpo, ky vullnet për transparencë, nuk është reflektuar mjaftueshëm në praktikë.

Nga 138 kërkesa për qasje në informata dhe dokumente publike të adresuara në sistemin prokurorial, IKD ka pranuar 68 përgjigje pozitive (50%), 16 përgjigje negative (10%), ndërsa 54 sosh (40%) kanë mbetur pa përgjigje. Vetëm në KPK, IKD gjatë kësaj periudhe ka parashtruar 38 kërkesa të tilla, nga të cilat, në 20 raste (52%) ka pranuar përgjigje pozitive, në 4 raste (10%) ka pranuar përgjigje negative, ndërsa në 14 kërkesa tjera (36%), KPK nuk ishte përgjigjur fare.¹⁶



Grafiku 2: Transparenca e sistemit prokurorial gjatë vitit 2022.

Sa i përket publikimit të vendimeve, gjatë vitit 2022 KPK ka nxjerrë 188 vendime¹⁷, nga të cilat vetëm 96 vendime janë publikuar ueb-faqen e KPK-së¹⁸. Shprehur në përqindje, i bie se KPK gjatë vitit 2022 ka publikuar 51% të vendimeve, ndërsa nuk ka publikuar 49% të vendimeve. Krahasuar me vitin 2021 dhe 2020, rezulton se KPK ka publikuar më pak vendime të tilla, çka dëshmon një rënie të nivelit të transparencës. Me publikimin e vendimeve, Këshilli do duhej të

¹³ Rregullore nr.03/2019 për Shërbimin e Komunikimit publik në sistemin prokurorial.

¹⁴ Strategjia për Komunikim e sistemit prokurorial 2021-2023.


¹⁵ “Plani vjetor i Punës 2022 i Këshillit Prokurorial të Kosovës”.

¹⁶ **Shënim:** Sipas komenteve të KPK-së (6 prill 2023) të gjitha kërkesat janë trajtuar në bazë të ligjit përkatës dhe janë realizuar për aq sa ka pasur mundësi dhe hapësirë ligjore.

¹⁷ Përgjigje e KPK-së për IKD. 11 janar 2023.

¹⁸ Të dhënat e fundit lidhur me publikimin e vendimeve janë nxjerrur më 16 mars 2023.

tregonte së paku një transparencë minimale, mirëpo KPK as këtë minimum të transparencës nuk ka arritur ta përmbush edhe pse ky obligim është një detyrim ligjor sipas Ligjit për Këshillin Prokurorial dhe aktet e tjera nënligjore. (Shih grafikun nr.3).



Grafiku 3: Regresi i KPK-së në publikimin e vendimeve gjatë periudhën 2020-2022

Mos publikimin e të gjitha vendimeve KPK e arsyeton se jo të gjitha vendimet janë publike, ku sipas tyre vendimet që kanë të bëjnë me raportet e performancës së prokurorëve, vendimet në rastet kur është duke u zhvilluar procedura disiplinore ndaj ndonjë prokurori dhe se në këto raste publikohen vetëm vendimet e gjykatës dhe jo vendimet e Këshillit. Po ashtu, sipas KPK-së ka vendime që kanë të bëjnë me emërimin e prokurorëve me mandat fillestar dhe të përhershëm që nuk publikohen por edhe vendime të tjera që me kërkesa të njësive organizative dhe prokurorive nuk bëhen publike.¹⁹

Lidhur me këtë përgjigje të KPK-së, IKD konsideron se duke marrë për bazë monitorimin e takimeve të KPK-së nga IKD, vendimet jo publike të kësaj të fundit nuk mund të përbëjnë më shumë se 10% të vendimeve të nxjerrura gjatë një viti, kjo duke u bazuar edhe në Ligjin për KPK në rastet kur Këshilli mund të mbajë takime të mbyllura.²⁰ Ndërsa, KPK gjatë vitit 2022 nuk ka publikuar gjithsej 49% të vendimeve të nxjerrura. Kështu, nuk qëndron argumenti i KPK-së se nuk janë publikuar vetëm vendimet të cilat sipas ligjit nuk duhet të publikohen. Po ashtu nuk qëndron argumenti se vendimet e procedurave disiplinore të prokurorëve nuk publikohen nga ky Këshill, pasi KPK vendime të tilla të formës së prerë ka publikuar në disa raste [Shih vendimin: *KPK/Nr.510/2022* ose *KPK/Nr.512/2022*].

Mungesa e transparencës e ka përcjellë edhe punën e Komisioneve të Përhershme të Këshillit, pasi edhe përkundër që ekziston një dritare e veçantë për të njëjtat në ueb-faqen e KPK-së, aty

¹⁹ Përgjigje e KPK-së për IKD. 6 prill 2023.

²⁰ Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Neni 14, par 3.

nuk ka të dhëna të detajuara lidhur me vendimet, raportet dhe planet e punës. Mungesa e të dhënave të tilla i pamundëson publikut që të njoftohen lidhur me punën e këtyre komisioneve.

Mungesë të transparencës KPK dhe PSH kishin treguar edhe ndaj një partneri serioz ndërkombëtar siç është Ambasada Britanike në Kosovë, duke injoruar ofertën e kësaj Ambassade për mbështetje të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit. Ky injorim pa dyshim se përçon një mesazh negativ tek opinioni publik duke dëmtuar rëndë kredibilitetin e njërit nga proceset më të rëndësishme në sistemin prokurorial, siç është ai i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit.²¹

Në anën tjetër, mungesë e transparencës është treguar edhe në dy (2) takime të Këshillit. Në njërin rast [Takimi i 21 prillit 2022], nuk është publikuar rendi i ditës, por vetëm është dërguar komunikata për media, derisa në rastin tjetër [Takimi i 217, 14 korrik 2022] nuk është dërguar as komunikata për media. Po ashtu, me mungesë të transparencës është mbajtur edhe takimi elektronik i 24 nëntorit 2022, pasi për të njëjtin nuk ishte bërë publik rendi i ditës e as nuk ishte lëshuar komunikatë për media. IKD i rekomandon KPK-së që gjatë vitit 2023 të mos e vazhdojë një praktikë të tillë të mbajtjes së takimeve elektronike, por ti ndërmarr të gjitha veprimet konkrete në mënyrë që edhe për këto takime të bëhet publik rendi i ditës sipas afatit të përcaktuar ligjor.

Kritika për mos transparencë lidhur me takimet e KPK-së kishin pasur edhe vetë anëtarët e Këshillit. Prokurorja Jehona Grantolli në një nga takimet e KPK-së kishte kërkuar nga Këshilli që mbledhjet e KPK-së të transmetohen sikurse transmetohen mbledhjet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.²²

4.1.(Mos) respektimi i dy gjuhësisë në publikimin e vendimeve

KPK edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar me praktikën tashmë të zakonshme të mospublikimit të të gjitha vendimeve dhe akteve tjera edhe në gjuhën serbe. Kjo pasi gjatë vitit 2022 janë publikuar vetëm 26 vendime në gjuhën serbe nga 188 sa i ka nxjerrë Këshilli gjatë vitit 2022. Shprehur në përqindje i bie që vetëm 13% e vendimeve të nxjerra nga KPK janë publikuar në faqen e saj zyrtare. Ndërsa, nga pesë (5) rregulloret e miratuara, vetëm tri (3) prej tyre janë publikuar në gjuhën serbe.

IKD i rikujton sërish KPK-së se dy (2) gjuhësia është parim kushtetues, i cili duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet publike. Për më tepër, në kuadër të sistemit prokurorial janë të

²¹ “Ekskluzive (dokument): Si Maloku dhe Lumezi injoruan për dy muaj ofertën e Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit?”, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-dokument-si-maloku-dhe-lumezi-injoruan-per-dy-muaj-oferten-e-ambasades-britanike-per-mbeshtetje-te-procesit-te-zgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shkurt 2023).

²² “Me polemika mes anëtarëve, KPK vendos që të publikohen intervistat dhe koncept-dokumentet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 16 mars 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/me-polemika-mes-anetareve-kpk-vendos-qe-te-publikohen-intervistat-dhe-koncept-dokumentet-e-kandidateve-per-kryeprokuror-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 prill 2023).

angazhuar edhe prokurorë serbë e sipas raportit të PSH për nëntëmuajorin e vitit 2022, janë 14 ose 7,65% prokurorë nga ky komunitet, prej tyre edhe anëtarë në KPK-së dhe mos publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera në gjuhën serbe përpos që paraqet shkelje kushtetuese, paraqet edhe pamundësi për prokurorët serbë dhe stafin mbështetës që të njohin rregullat e përcaktuara nga KPK.

5. (Mos) Përmbushja e planit të punës

KPK në shkurtin e vitit 2022 ka miratuar dhe publikuar planin e punës për vitin 2022. KPK disa nga planifikimet e përfshira ka arritur ti përmbush, ndër to miratimin e Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022 – 2024, themelimin i Grupit punues për monitorimin e këtij plani, miratimi i Rregullores për Zgjedhjen dhe Përfundimin e Mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, miratimin e Rregullores për Rekrutimin e Zyrtarëve të Lartë për Bashkëpunim Profesional, miratimin e rregullores për praktikantë etj. Ndërkaq, sa i përket objektivave për ngritjen e transparencës dhe të komunikimit të publikut dhe mediat, KPK nuk ka arritur që ti përmbush shumicën e objektivave të planifikuara, si prezenca e KPK-së në rrjete sociale dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të takimeve të saj në ueb-portalin e sistemit prokurorial.

23

Në anën tjetër, shumë nga objektivat e planifikuara me këtë plan të punës nuk janë arritur të përmbushen gjatë këtij viti, siç janë:

- 1) Plotësim/ndryshimi i Rregullores 05/2019 për Përgjegjësi Disiplinore të Prokurorëve
- 2) Miratimi i Rregullores për Vepimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit të KPK-së²⁴
- 3) Miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit
- 4) Hartimi i Rregullores për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve në Institucionin e Prokurorit të Shtetit
- 5) Hartimi i udhëzuesit për unifikimin e çmimeve të ekspertizave për gjithë sistemin prokurorial të parapara me Rregulloren 15/2015 për emërimin e ekspertëve gjyqësor
- 6) Raportimi i rregullt i kryeprokurorëve për çështjet e administrimit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve
- 7) Themelimi i mekanizimit për çështje të etikës së prokurorëve²⁵ etj.

²³ “Plani vjetor i Punës 2022 i Këshillit Prokurorial të Kosovës”

²⁴ **Shënim:** Miratimi i kësaj Rregullore ishte planifikuar të bëhet edhe gjatë vitit 2021 pasi nuk ka arritur të miratohet në atë vit ishte bartur në Planin e Punës për vitin 2022 por që edhe gjatë këtij viti kjo rregullore nuk ka arritur të miratohet, e që sërish është bartur për vitin pasues, pra për vitin 2023.

²⁵ **Shënim:** Themelimi i këtij mekanizmi ishte paraparë edhe në planin e punës për vitin 2021 por që nuk ishte themeluar i njëjti.

Planet e punës nuk mund të shihen vetëm si planifikime të mbetura në letër dhe si obligime formale, e aq më pak siç nuk duhet të jetë një plan me objektiva abstrakte dhe me afate të gjata kalendarike për përmbushjen e atyre objektivave.²⁶ Në këtë drejtim, IKD i rekomandon KPK-së që në miratimin e planit vjetor të punës, të tregojë synime të qarta, duke vendosur objektiva të cilat janë të matshme dhe që përgjatë një viti të ushtrojë një mbikëqyrje strikte për arritjen e objektivave të planifikuara gjatë një viti kalendarik.

6. Betejat e fituara ligjore të IKD-së për transparencë ndaj Sistemit Prokurorial

6.1. Fletëpoentimet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit

Në vitin që lamë pas, u zhvillua njëri ndër proceset më të rëndësishme, ai i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, proces ky i kontestuar sipas shoqërisë civile²⁷, partnerëve ndërkombëtar dhe akterëve të tjerë. Pozitive në këtë proces ishte parë transmetimi i intervistave të kandidatëve në televizionin publik, publikimi i Koncept Dokumenteve të kandidatëve, kështu duke lejuar monitorimin direkt të këtij procesi. Mirëpo, ndonëse dosjet e poentimit të kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit janë dokumente publike, të cilat nuk përbëjnë të dhëna konfidenciale, KPK nuk ka dhënë qasje në të njëjtat.

Kështu, koalicioni i Organizatave Joqeveritare, Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Lëvizja FOL, kishin ushtruar ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), për heshtje në kërkesën për qasje në dokumente publike të 4 Prillit 2022, më çka AIP me 6 qershor 2022 ka marrë vendim me të cilin e ka detyruar KPK-në, që të ofrojë qasje në këto fletëpoentime.²⁸

6.2. Aktvendimet për hudhjen e kallëzimeve penale dhe pushimet e hetimeve

Një hap të rëndësishëm për të trasuar rrugën edhe OJQ-ve dhe mediave, ishte fitorja e IKD-së dhe Betimi për Drejtësi ndaj Prokurorisë Themelore në Prishtinë për qasje në vendimet e hudhjes së kallëzimeve penale. IKD në vazhdimësi ka kërkuar që të ofrohet qasje në dokumentet e tilla, krejt kjo me qëllim që të kuptohet se cilat janë arsyetimet e prokurorëve në rastet kur hudhin kallëzimet penale e po ashtu edhe kur pushohen hetimet. E gjithë kjo në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

²⁶ **Shënim:** Shumica e objektivave-aktiviteteve të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2022 kanë një afat të përmbushjes prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2022. Një planifikim i tillë krijon kaos dhe shumica e objektivave mbesin pa u përmbushur, për shkak se nuk është përcaktuar një afat kohor i shkurtër për secilën objektiv.

²⁷ IKD, GLPS, FOL: “Integriteti i Përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit”. Prishtinë, mars 2022.

²⁸ “Pas ankesës së IKD, FOL dhe GLPS, Këshilli Prokurorial detyrohet të ofrojë qasje në poentimin e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 6 qershor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-ankeses-se-ikd-fol-dhe-glps-keshilli-prokurorial-detyrohet-te-ofroje-qasje-ne-poentimin-e-kandidateve-per-kryeprokuror-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 15.02.2023)

Pasi, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte heshtur në kërkesën për qasje në 7 vendime të kësaj prokurorie, IKD dhe BPD kishin ushtruar ankesë në AIP, ku kjo e fundit më 6 prill 2022 kishte detyruar prokurorinë që të lejohet qasje në dokumentet e kërkuara.²⁹

Kjo ikje nga përgjegjësia e prokurorëve ka përfunduar, falë fitores së IKD-së dhe BPD-së që përmes shfrytëzimit të mekanizmave ligjor në fuqi kanë rrëzuar këtë praktikë të kundërligjshme. Ky obligim ligjor tani më paraqet standard të vendimmarrjes dhe si i tillë vlen njëjtë për të gjitha prokuroritë dhe prokurorët e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, një vendim i tillë ofron më shumë siguri juridike për qytetarët por edhe ngrit kualitetin e punës së prokurorëve, vendimet e të cilëve tani e tutje janë objekt i monitorimit nga publiku.³⁰

7. (Jo) transparenca e kryesuesit Maloku për mediat dhe publikun

Janë bërë dy vite që prej kur Jetish Maloku është zgjedhur kundërligjshëm³¹ si kryesues i KPK. E për dy vite për gazetarët e publikun ai u paraqit vetëm katër herë dhe atë në konferencat përmbyllëse për vitin 2021 dhe 2022 dhe dy (2) herë në intervista për media.³² Që nga zgjedhja e tij në krye të KPK-së në janar 2021, Maloku vazhdimisht kishte proklamuar transparencë dhe llogaridhënie para publikut. I njëjti, kishte paraqitur tri objektiva në mandatin e tij, një ndër të cilat ishte **transparenca**.³³ Sipas KPK, Maloku gjatë mandatit të tij, ka dalë para mediave atëherë kur ka qenë e nevojshme. Po ashtu, është theksuar se Kryesuesi Maloku ka dhënë intervista për media të ndryshme të vendit dhe të huaja, duke pasqyruar aktivitetet e përgjithshme dhe të veçanta të KPK-së³⁴. Përrjashtimisht një interviste të dhënë në vitin 2022 dhe një në vitin 2023³⁵, IKD nuk ka gjetur asnjë intervistë tjetër të dhënë nga Kryesuesi i KPK-së, as në mediat vendore as në mediat ndërkombëtare. IKD ka pyetur KPK në lidhje me këto intervista, mirëpo deri në publikimin e këtij raporti këta të fundit nuk kanë kthyer përgjigje.

Maloku ka zhvilluar vetëm një intervistë gjatë vitit 2022, përkundër kërkesave. Vetëm “*Betimi për Drejtësi*”, të paktën dhjetëra herë e ka ftuar Malokun në intervistë, për të diskutuar lidhur me funksionimin e KPK-së, e cila temë paraqet interes për publikun. Kryesuesi Maloku në secilën

²⁹ “Pas ankesës së “*Betimit për Drejtësi*”, kryeprokurori Kujtim Munishi detyrohet të ofrojë qasje në dokumentet publike”. *Betimi për Drejtësi*. 17 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-ankeses-se-betimit-per-drejtesi-kryeprokurori-kujtim-munishi-detyrohet-te-ofroje-qasje-ne-dokumentet-publike/>). (Qasur për herë të fundit më 16 shkurt 2023).

³⁰ “*Promo: Fitorja e IKD-së dhe BpD-së ndaj KPK-së*”. *Betimi për Drejtësi*. 3 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=F0Qemg7ICvo>). (Qasur për herë të fundit më 16 shkurt 2023).

³¹ Makshana, L. Thaqi, M: “*Administrimi i Sistemit të Drejtësisë nga Këshillat*”. Prishtinë. Qershor 2022. Fq.22

³² “*Maloku: 1000 -1050 euro pritet të jetë paga e gjyqtarëve e prokurorëve*” (Shih linkun: <https://www.facebook.com/watch/?v=1569876703473145>). (Qasur për herë të fundit më 8 prill 2023)

³³ “*U mbajt ceremonia e pranimit-dorëzimit të detyrës së Kryesuesit të KPK-së*”. KPK. 18 janar 2021. (Shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/kpk/lajm/6302>). (Qasur për herë të fundit më 19 shkurt 2023).

³⁴ Komentet e KPK-së në këtë Raport. 6 prill 2023.

³⁵ Shih linkun: <https://www.facebook.com/watch/live/?ref=search&v=914896216178304>). (Qasur për herë të fundit më 8 prill 2023).

herë kishte premtuar se kjo intervistë do të realizohej, por se asnjëherë nuk ka pasur vullnetin për të realizuar intervistën.³⁶

Kështu, për dallim nga KGJK por edhe nga kryesuesit e mëhershëm të KPK-së, kryesuesi Maloku për vitin 2022 ka zgjedhur që paraqitet e tij në media të jenë të rralla apo të mos të paraqitet fare, përkundër premtimeve të tij për transparencë.

8. Dështimi i mekanizmave të llogaridhënies në KPK

8.1. Dështimi i KPK-së në adresimin e përgjegjësisë disiplinore në rastin e vrasjes së S.M

Siç është thënë më lartë shumica e vendimeve disiplinore të shqiptuara nga KPK gjatë vitit 2022 kishin përfunduar me masa të buta disiplinore si vërejtje publike dhe vërejtje jo publike me shkrim. Vetëm një rast kishte përfunduar me masë më të rëndë, përkatësisht transferimin e një prokurori. Sipas raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2022 edhe pse ka përpjekje për të zbatuar kornizën e duhur ligjore në lidhje me procedurat disiplinore, megjithatë nevojitet shumë vullnet, zell dhe punë për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të procedurave disiplinore.³⁷

Që nga 14 marsi 2021, kur e ndjera S.M u vra nga ish-burri i saj, i cili po ashtu kishte vrarë edhe vetën, institucionet përgjegjëse ende nuk kanë ndërmarrë kurrfarë masa për ta adresuar përgjegjësinë institucionale në këtë drejtim.

Përkritazi me këtë rast, IKD dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), më 17 mars 2021, kishin publikuar një analizë ku dëshmonin shkeljen e së drejtës në jetë së S.M. Në këtë raport ishin prezantuar gjetjet kryesore dhe shkeljet e institucioneve shtetërore, duke përfshirë edhe rekomandimet për llogaridhënie në rastin konkret. Sipas IKD-së dhe RrGK, që nga data 4 mars 2021, Prokurori i Shtetit nuk ka ndërmarr asnjë veprim hetimor apo veprim tjetër për të zbardhur rastin apo masë për t'i ofruar mbrojtjen e nevojshme tanimë viktimës S.M. Gjithashtu, IKD dhe RrGK kishin vlerësuar se Republika e Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe institucionet tjera shtetërore përmes mos veprimit të tyre, mos përmbushjes së obligimeve ligjore në rastet kur cenohet integriteti i grave tek veprat penale të dhunës në familje ia kanë shkelur tani të ndjerës S. M të drejtën për jetë, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë, si e drejta më elementare njerëzore, nga e cila e drejtë derivojnë edhe të gjitha të drejtat e tjera.³⁸

Këto pretendime të IKD-së dhe RrGK-së ishin vërtetuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 22 mars 2023. Kjo e fundit ka marrë vendim lidhur me kërkesën e dorëzuar nga vajza e të ndjerës S.M, përmes të cilit konstatohet shkelja e të drejtës për jetën, e garantuar me Kushtetutë. Kjo

³⁶ “Frika e sistemit prokurorial nga transparenca?”. Betimi për Drejtësi. 8 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-289-frika-e-sistemit-prokurorial-nga-transparenca/>). (Qasur për herë të fundit më 26 mars 2023).

³⁷ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022.

³⁸ Rrezniqi, A & Shala, G. “Shteti me mos veprim, privon nga jeta Sebahate Sopin”. Mars 2021. Prishtinë. Fq. 4.

kërkesë ishte hartuar nga Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së, në emër të fëmijëve të tani të ndjerës dhe ishte dorëzuar nga vajza e saj V.S.³⁹

Në rastin konkret, përkundër faktit se e tani e ndjera S.M e kishte raportuar rastin në Polici dhe Prokurori dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për mbrojtjen e të njëjtës, siç përshkruhet në detaje edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.KI129/21, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar llogaridhënien në rastin konkret. Në këtë drejtim, duhet theksuar se Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë e kishte paragjykuar këtë rast që nga fillimi, duke refuzuar në mënyrë kategorike që të zhvillojë hetime për adresimin e llogaridhënien në këtë rast.

Përballë nevojës që Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë të veprojë si Autoritet kompetent dhe të përmbushë obligimet e tij, ai kishte zgjedhur që të fyej IKD-në përmes komunikatës për media të lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. Komunikata për media e elaboruar më lartë flet për vendosmërinë e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë për mos ta adresuar llogaridhënien në rastin konkret. Siç u tha më lartë, përmes komunikatës për media, Prokuroria Themelore në Prishtinë, e udhëhequr nga z. Kujtim Munishi, i kishte cilësuar gjetjet e IKD-së si *“të paqëndrueshme, joprofesionale dhe tendencioze të cilat si qëllim kanë dëmtimin e punës, imazhit dhe krijimin e mosbesimit të qytetarëve në Institucionin e Prokurorit të Shtetit”*⁴⁰. Por, në fakt, të gjithë këto pretendime janë vërtetuar si përmes Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit Nr. Nr. 150/2021 e po ashtu edhe aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese Nr.KI129/21.

Sistemit Prokurorial as dy vite nuk i kishin mjaftuar për ta adresuar përgjegjësinë disiplinore për këtë rast edhe përkundër gjetjeve të IKD-së, RrGK dhe Avokatit të Popullit.⁴¹ Inicimi i procedurës disiplinore është bërë tek pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kjo vetëm për prokurorin e rastit.⁴²

8.2.Rasti i dhunimit të 11 vjeçares dhe rasti i vrasjes së S.D

Gjatë vitit 2022, kanë ndodhur edhe dy raste tjera të cilat kanë tronditur opinionin publik. Rasti i dhunimit të 11 vjeçares⁴³ dhe rasti i vrasjes së të ndjerës S. D, e për të cilat raste sistemi

³⁹ Shih: Aktgjykimi nr.KI129/21. 22 mars 2023.

⁴⁰ “Reagim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë”. Prishtinë. 17 mars 2021. (Shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/psb/lajm/6547>). (Qasur për herë të fundit më 12 prill 2023)

⁴¹ “Raport i Avokatit të Popullit- Ex officio nr. 150/2021”. 27.04.2021.

⁴² “Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, iniciohet procedurë disiplinore ndaj prokurorit të rastit të Sebahate Morinës”. Betimi për Drejtësi. 5 prill 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-vendimit-te-gjykatës-kushtetuese-iniciohet-procedure-disiplinore-ndaj-prokurorit-te-rastit-te-sebahate-morines/>). (Qasur për herë të fundit më 11 prill 2023)

⁴³ “40 vite burgim ndaj katër të përfshirëve në dhunimin e 11 vjeçares, njëri lirohet nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 24 shkurt 2023. (<https://betimiperdrejtesi.com/40-vite-burgim-ndaj-kater-te-perfshireve-ne-dhunimin-e-11-vjecares-njeri-lirohet-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 12 prill 2023).

prokurorial ende nuk ka njoftuar publikun nëse është iniciuar ndonjë procedurë disiplinore ndaj prokurorëve të rastit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse.

Lidhur me rastin e dhunimit të 11-vjeçares, Avokati i Popullit më 31 gusht 2022 kishte hapur rast ex-officio dhe kishte marrë informatat e nevojshme nga institucionet përgjegjëse lidhur me rastin. Pas analizimit të rastit, Institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me konstatime lidhur me gjetjet e rastit, ku janë evidentuar një sërë shkeljesh. Në raportin e publikuar me 3 prill 2023 nga Avokati i Popullit janë përshkruar veprimet e secilit institucion ku janë evidentuar veprimet dhe mosveprimet e institucioneve përgjegjëse në rastin e dhunimit të 11 vjeçares. Në pjesën e rekomandimeve në këtë raport ndër të tjera është theksuar nevoja e ndërmarrjes së masave nga KPK për sigurimin e llogaridhënies për zyrtarët përgjegjës të përfshirë në rast, për shkak të dështimit që ti përmbushin detyrimet ligjore.⁴⁴ Ky rast është përmendur edhe në raportin për të Drejtat e Njeriut të Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën (DASH).⁴⁵

As me rastin e tani të ndjerës S.D, deri më tani nuk është adresuar përgjegjësia disiplinore. Më 8 nëntor 2022, në fshatin Kuk, Komuna e Dragashit, N.A dhe J.A në bashkëveprim me njërin tjetrin dhe në shtëpinë e tyre të përbashkët akuzohen se kanë kryer dhunë psikike ndaj të dëmtuarës/ kunatës dhe hallës së tyre S.D. Në raportin e publikuar nga IKD, ndër të tjera thuhet se Policia e Kosovës e kishte trajtuar këtë rast në ditën e njëjtë dhe kishte njoftuar Prokurorin kujdestar dhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhim të Viktimave (ZMNV). Të njëjtën ditë, Prokurori kujdestar i kësaj Prokurorie kishte vendosur që rasti të procedohet në procedurë të rregullt. Ndërsa, shtatë (7) ditë më vonë, me 15 nëntor 2022, Policia e Kosovës kishte proceduar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore të Prizrenit. Ndërsa nëntë (9) ditë më vonë, kjo Prokurori ka filluar hetimet. Deri më 21 dhjetor 2022, kur Prokuroria Themelore në Prizren kishte ngritur aktakuzë për këtë rast, kjo Prokurori nuk kishte ndërmarrë veprime shtesë për mbrojtjen e viktimës. Kjo lëndë ishte trajtuar në procedurë të rregullt, pasi kjo Prokurori nuk kishte iniciuar ndonjë kërkesë për caktimin e ndonjë prej masave për caktimin e sigurisë së personit në procedurë penale. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, ndaj viktimës nuk kishte pasur të shqiptuar asnjë urdhër mbrojtës. Kjo pasi për këtë rast, edhe pse ZMNV kishte qenë e njoftuar, nuk kishte bërë fare kërkesë për caktimin e urdhrit mbrojtës sipas Ligjit për Mbrojtje nga dhuna në familje. Qendra për Punë Sociale në Dragash e kishte vizituar viktimën në këtë rast. Kjo Qendër, me arsyetimin se e kishte ditur nga rastet e tjera se strehimoret nuk kanë kushte adekuate për raste si ky, nuk e kishte referuar fare rastin në Strehimore.⁴⁶ Ndryshe, IKD me 30 janar 2023 ka paraqitur kërkesë tek Avokati i Popullit për fillimin e hetimeve për shkelje të të drejtave të njeriut, ku nga ky institucion është kërkuar që ta trajtojë këtë çështje dhe të zhvillojë hetime në mënyrë që të konstatohet nga ky institucion se nga ana e autoriteteve të lartcekura, tani të ndjerës

⁴⁴ "Raporti i Avokatit të Popullit- Ex-officio nr.468/2022". 03.04.2023 (Shih linkun: [file:///C:/Users/hp/Downloads/Raporti-I-AP-Ex-officio-468-2022%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/hp/Downloads/Raporti-I-AP-Ex-officio-468-2022%20(1).pdf)).

⁴⁵ Kosovo 2022 Human Rights Report.

⁴⁶ Rrezniqi,A & Shala,G."Edhe Saime Domazeti vritet në duart e shtetit". Dhjetor 2022. Prishtinë.

S.D i janë shkelur të drejtat të përcaktuara me Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligje dhe akte të tjera.

Lidhur me këtë çështje, pavarësisht këtyre dështimeve, për Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, ky rast nuk mund të parandalohet, pasi sipas tij, askujt nuk do i shkonte në mendje se mund të kryhej një veprë e tillë.⁴⁷ IKD konsideron se deklarime të tilla janë jo serioze, pasi akterët shtetëror asnjëherë nuk guxojnë të hamendësojnë nëse do të kryhet apo jo një veprë penale, mirëpo në raste të tilla posaçërisht të dhunës në familje duhet të merren të gjitha veprimet në mënyrë që të parandalohet kryerja e një veprë penale e cila mund të ketë edhe pasoja fatale.

Fatkeqësisht, në këtë rast, dhe jo vetëm, dështimi zinxhiror i institucioneve e bën edhe një herë të qartë se dhuna në familje është duke u trajtuar me mungesë të thellë të profesionalizmit, me mos përgjigje adekuate ndaj këtij fenomeni dhe me mungesë të llogaridhënies nga akterët përgjegjës.

9. Integriteti i kontestuar i procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit

Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit nga KPK gjatë vitit 2022 ishte shoqëruar me parregullsi të shumta duke e bërë këtë proces të kontestuar. Ky konkurs ishte shpallur nga KPK më 12 janar 2022, kjo pasi Aleksandër Lumezit, i cili e kishte ushtruar këtë pozitë, i ka përfunduar mandati më 21 prill 2022. Pas një procesi disa javor në mënyrë unanime KPK votoi prokurorin Blerim Isufaj, për Kryeprokuror të Shtetit dhe e rekomandoi atë për dekretim te presidentja Vjosa Osmani.⁴⁸

Në anën tjetër KPK ka vlerësuar se në deklaratimet lidhur me procesin e rekrutimit për Kryeprokuror të Shtetit ka pasur shumë të pavërteta dhe deklarime joprofesionale, të ulëta dhe qëllimkëqija, në raport me sistemin prokurorial të Kosovës. Po ashtu, KPK ka theksuar se në këtë aspekt opinioni publik është dezinformuar, ngase Këshilli Prokurorial i Kosovës që nga dita kur ka marrë vendim për shpalljen e konkursit ka qenë transparent dhe i hapur, me ç'rast të gjitha procedurat janë zhvilluar në transparencë të plotë para partnerëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Po ashtu, vazhdimisht është bërë thirrje për monitorimin e këtij procesi.⁴⁹

Mirëpo, ky proces ngjalli reagime të shumta në Kosovë me çka reagues Shoqëria Civile dhe ambasadat kryesore në vend. Sipas koalicionit të OJQ-ve, procesi i përzgjedhjes së

⁴⁷ “Kryeprokurori Shala: Vrasja e Saimë Domazetit nuk mund të parandalohet”. Betimi për Drejtësi. 21 janar 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-shala-vrasja-e-saime-domazetit-nuk-mund-te-parandalohet/>). (Qasur për herë të fundit më 12 prill 2023)

⁴⁸ “KPK voton Blerim Isufajn për Kryeprokuror të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 6 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohen-kundershtimet-e-kandidateve-per-kryeprokuror-te-shtetit-kpk-po-pergatitet-per-votimin-e-blerim-isufajt-per-kryeprokuror-te-ri-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2023).

⁴⁹ Komentet e KPK-së në këtë raport. 6 prill 2023.

Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka siguruar meritokraci, objektivitet dhe se kandidatët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, çka sipas koalicionit ky proces është shoqëruar me shkelje të shumta të procedurave. Po ashtu, Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde e kishte cilësuar procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit si zhgënjyes pasi sipas tij nuk ishin respektuar parimet për një proces të drejtë dhe të bazuar në meritokraci. Të habitur dhe të zhgënjyer me këtë proces kishin mbetur edhe Zyra e Bashkimit Evropian, duke e cilësuar si zhgënjyes veprimin e KPK-së për propozimin e Blerim Isufajt për Kryeprokuror të Shtetit. Gjithashtu, ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier, ka thënë se përzgjedhja e kryeprokurorit të Shtetit nga KPK bie ndesh me pritshmëritë e SHBA-së dhe të qytetarëve kosovarë se procesi duhet të ishte i drejtë, objektiv, transparent dhe i bazuar në merita.⁵⁰ Pra, integriteti i këtij procesi ishte cenuar qysh në fillim, pasi ishin tërhequr edhe nga monitorimi Ambasada Britanike, e cila ishte injoruar për dy muaj nga KPK dhe Kryeprokurori i Shtetit.⁵¹

IKD konsideron se argumentet e KPK-së për jo profesionalizëm në raportimet dhe analizat për procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të shtetit janë të paqëndrueshme, kjo për faktin se sikurse IKD por edhe Organizatat tjera të Shoqërisë Civile e kanë cilësuar këtë proces për mungesë të integritetit. Se qëndrimet e IKD-së lidhur me këtë çështje kanë qenë profesionale dhe të mbështetura në argumente e dëshmojnë edhe reagimet e ambasadave të huaja në Republikën e Kosovës dhe reagimet e OJQ-ve të tjera të cilat ishin shprehur të zhgënjyera me këtë proces. Për më tepër edhe Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022 ka theksuar zhgënjimin e ambasadave dhe shoqërisë civile për mungesën e drejtësisë, transparencës dhe parimeve të meritës në procesin e zhvilluar nga KPK.⁵²

⁵⁰ **Shënim:** Ndaj këtij procesi kanë reaguar Ambasada Britanike, Ambasada Gjermane, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Ambasada Amerikane, duke u shprehur të zhgënjyer me këtë proces.

“Edhe Gjermania e zhgënjyer me procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/edhe-gjermania-e-zhgenjyer-me-procesin-e-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/?fbclid=IwAR0_L4D_-4VtMuA4I6MiYZPXpb2TCOutkbTOW8YNarGj7fkZV2pwbD8vnU). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2023).

“Szunyog i reagon KPK-së pas votimit të Blerim Isufajt për Kryeprokuror të Shtetit: Jemi të habitur dhe të zhgënjyer”. Betimi për Drejtësi. 6 prill 2022. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/szunyog-i-reagon-kpk-se-pas-votimit-te-blerim-isufajt-per-kryeprokuror-te-shtetit-jemi-te-habitu-r-dhe-te-zhgenjyer/?fbclid=IwAR18t_fFSKo0qWVLOyCc-urUVsHmIJI9MGLYnucvP2xSKHifa6a7sm6FK0). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2023).

“Ambasadori amerikan i shqetësuar për mënyrën se si u votua për Kryeprokurorin e Shtetit, thotë se nuk u respektuan standardet”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ambasadori-amerikan-i-shqetesuar-per-menyren-se-si-u-votua-per-kryeprokurorin-e-shtetit-thote-se-nuk-u-respektuan-standardet/?fbclid=IwAR2ZFs4-44Tmbk498zmmvs-0lWfhw49AdRyt9l2QSyFNSVI4JLWZF2PyaHQ>). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2023).

⁵¹ *“Ekskluzive (dokument): Si Maloku dhe Lumezi injoruan për dy muaj ofertën e Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit?”*, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-dokument-si-maloku-dhe-lumezi-injoruan-per-dy-muaj-oferten-e-ambasades-britanike-per-mbeshtetje-te-procesit-te-zgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2023).

⁵² Raporti i Progresit për Republikën e Kosovës për vitin 2022. Fq.20.

Tashmë, çështja e Kryeprokurorit është në duart e Presidentes Vjosa Osmani e cila ende nuk ka marrë një vendim që ta dekretoj apo jo Blerim Isufajn si Kryeprokuror. Përderisa, IKD rithekson nevojën që Kryeprokurori i Shtetit të dalë nga një proces i cili ka integritet të pa kontestuar.

10. Reagimi jo adekuat i KPK-së ndaj Qeverisë

Qeveria e Republikës së Kosovës në nëntor të vitit 2022 kishte marrë vendim për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.⁵³

IKD dhe Organizatat e tjera të Shoqërisë Civile kishin reaguar ashpër ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe duke përdorur fakte të pavërteta kishte nxjerrë vendim për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përmes, një reagimi IKD dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile kishin konsideruar se vendimi i Qeverisë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve paraqet qartazi ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit dhe është në kundërshtim me standardet e ndërtuara nga Komisioni i Venecias.⁵⁴

Mirëpo, rruga të cilën e kishte ndjekur KPK për të iu përgjigjur këtij vendimi të Qeverisë ishte jo adekuate. KPK me 23 nëntor kishte nxjerrë vendim përmes të cilit kishte vendosur për të reduktuar punën në Prokurori, ku sipas këtij vendimi do të punohej vetëm me shërbime esenciale. Po ashtu, sipas këtij vendimi prokuroritë kishin pezulluar të gjitha format e bashkëpunimit me përfaqësuesit e Qeverisë. Këshilli vendimin e Qeverisë e kishte quajtur si vendim kundërkushtetues dhe kundërligjor, si dhe ndërhyrje flagrante në pavarësinë e sistemit prokurorial.⁵⁵ Një vendim i tillë i KPK-së ka bërë që shumë veprime për trajtimin e rasteve nga prokuroritë të pezullohen. Ky pezullim i punës në prokuroritë e vendit kishte zgjatur deri me 5 dhjetor 2022, kjo pasi GjTh në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative kishte aprovuar masën e përkohshme të Shoqatës së Prokurorëve ndaj vendimit të qeverisë për paga.⁵⁶

IKD konsideron se njësoj sikurse KGJK edhe KPK është dashur ti ndjekin rrugët ligjore qysh në fillim ndaj vendimit të Qeverisë për uljen e pagave dhe të mjaftohen me këtë. Pezullimi i punës ka shkuar në dëm të të drejtave të qytetarëve. Përballë një vendimi kundër kushtetues të Qeverisë, sistemi i drejtësisë do të duhej të ishte shembull dhe model i asaj se si mbrohet një e drejtë përmes

⁵³ Vendimi Nr.03/109 i datës 23.11.2022.

⁵⁴ “Shoqëria civile: Ulja e pagave për sistemin e drejtësisë paraqet ndërhyrje në drejtësi dhe rrit potencialin korruptiv”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 23 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/shoqeria-civile-ulja-e-pagave-per-sistemin-e-drejtësisë-paraqet-nderhyrje-ne-drejtësi-dhe-rrit-potencialin-korruptiv/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

⁵⁵ “Pas vendimit për pagat, edhe KPK redukton punën e prokurorëve dhe pezullon bashkëpunimin me Qeverinë”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtësi.com/pas-vendimit-per-pagat-edhe-kpk-redukton-punen-e-prokurorëve-dhe-pezullon-bashkëpunimin-me-qeverinë/>). (Qasur për herë të fundit më 15 shkurt 2023).

⁵⁶ “Pezullimi i vendimit për pagat, edhe Prokuroritë i kthehen punës të hënën me kapacitete të plota”. Betimi për Drejtësi. 2 dhjetor 2022 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtësi.com/pezullimi-i-vendimit-per-pagat-edhe-prokurorite-i-kthehen-punes-te-henen-me-kapacitete-te-plota/>). (Qasur për herë të fundit më 15 shkurt 2023).

rrugëve ligjore dhe jo të merrte veprime që shkojnë në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

11. Kërcënimet e KPK-së me mos zbatim të ligjit

Sipas Ministrisë së Drejtësisë (MD), KPK konsiderohej si përgjegjësi kryesor për mungesë të integritetit dhe profesionalizmit.⁵⁷ Kjo Ministri, në kuadër të reformave ligjore të identifikuar në Strategjinë për Sundimin e Ligjit ndër hapat e parë që ndërmori ishte reformimi i Këshillit Prokurorial përmes ndryshimit të Ligjit të KPK-së. Kuvendi i Republikës së Kosovës me 23 qershor 2022 miratoi në lexim të dytë Projektligjin për KPK.⁵⁸ Mirëpo, me 24 mars 2023, Gjykata Kushtetuese e shpalli si të pavlefshëm këtë ligj, pasi sipas kësaj të fundit ky ligj nuk ishte në përputhje me Kushtetutën⁵⁹. Kujtojmë se IKD kishte raportuar se kjo gjykatë nuk kishte vendosur brenda afatit 60 ditor, ashtu siç parashihet me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.⁶⁰ Ndaj, vendimit të Gjykatës Kushtetuese për rrëzimin e Ligjit të ri për KPK janë shprehur të befashuar nga Ministria e Drejtësisë⁶¹, teksa ky vendim është mirëpritur nga KPK⁶².

Ndryshe, me Ligjin e ri për KPK i cili tashmë është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese parashihej një ristrukturim i tërësishëm i këtij institucioni, pasi ishte përcaktuar që numri i anëtarëve të KPK-së do të zvogëlohej nga trembëdhjetë (13) në shtatë (7) anëtarë. Po ashtu, ky ligj parasheh që numri i anëtarëve prokuror dhe jo prokuror do të balancohej. Kështu, Këshilli do të përbëhej nga tre (3) prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre, si dhe Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare, ndërkaq tre (3) anëtarë do të jenë anëtar jo prokurorë. Dy (2) të zgjedhur nga Kuvendi dhe (1) një i emëruar nga Avokati i Popullit.

⁵⁷ “Komisioni për legjislacion shqyrtoi në parim Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës”. Ministria e Drejtësisë. 16 mars 2022. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2675>). (Qasur për herë të fundit më 26.03.2023).

⁵⁸ “Miratohet në lexim të dytë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës”. Betimi për Drejtësi, 23 qershor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/miratohet-ne-lexim-te-dyte-projektligji-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-ligjit-per-keshillin-prokurorial-te-kosoves>). (Qasur për herë të fundit më 23 shkurt 2023).

⁵⁹ “Kushtetuesja rrëzon Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës”. Betimi për Drejtësi. 24 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kushtetuesja-rrezon-ligjin-per-keshillin-prokurorial-te-kosoves/>). (Qasur për herë të fundit më 26 mars 2023).

⁶⁰ **Shënim:** “Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dorëzimit të kërkesës”, thuhet në nenin 43, par të këtij ligji.

⁶¹ “Ministrja e Drejtësisë: Për Gjykatën Kushtetuese më i rëndësishëm interesi i disa anëtarëve të KPK-së se sa interesi i përgjithshëm”. Betimi për Drejtësi. 25 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-e-drejtësisë-per-gjykatën-kushtetuese-me-i-rëndësishëm-interesi-i-disa-anëtarëve-te-kpk-se-se-sa-interesi-i-pergjithshëm/>). (Qasur për herë të fundit më 26 mars 2023).

⁶² “KPK mirëpret vendimin e Kushtetueses, i quan të pamatura dhe joserioze deklaratimet e Albulena Haxhiut”. Betimi për Drejtësi. 25 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-mirepret-vendimin-e-kushtetueses-i-quan-te-pamatura-dhe-joserioze-deklarimet-e-albulena-haxhiut/>). (Qasur për herë të fundit më 26 mars 2023).

Ndryshe, kundër ndryshimeve të reja ishte vetë KPK-ja, pasi ky institucion e kishte kundërshtuar në mënyrë kategorike miratimin e ligjit të ri, ku sipas tyre me këtë ligj cenohej rëndë pavarësia e këtij institucioni kushtetues. Të njëjtit e akuzonin MD se asnjëherë nuk i ka marrë parasysh propozimet e këtij institucioni. Po ashtu, KPK përmes një komunikate për media kishte theksuar se përmbajtja e këtij Ligji do ta pamundësojë funksionimin e sistemit prokurorial dhe sipas tyre këtë sistem do ta bëjë të ndikuar nga politika. Pas, miratimit të Ligjit, KPK kishte deklaruar se do ti ndjek të gjitha rrugët ligjore për ta kontestuar përmbajtjen e këtij Ligji, por përveç kësaj në të njëjtën komunikatë të njëjtit kishin theksuar se asnjë anëtar i Këshillit nuk do ti nënshtrohej kërkesave kundërkushtetuese dhe kundërligjore të këtij Ligji.⁶³

Ndjekja e rrugëve ligjore për ta kontestuar ligjshmërinë e këtij ligji është plotësisht e drejtë kushtetuese dhe ligjore e KPK-së. Mirëpo, deklaratimet e tyre se nuk do ta respektojnë ligjin janë deklarime skandaloze që nuk duhet të ndodhin në një rend të mirëfilltë juridik. Paralajmërimet për mosrespektim të ligjit nga një institucion Kushtetues siç është KPK-ja përçojnë mesazhe negative tek qytetarët dhe dëmtojnë rëndë imazhin e këtij institucioni. IKD në vazhdimësi ka kërkuar që reforma në Këshillin Prokurorial të Kosovës gjithsesi se duhet të ndodhë, por se kjo të ndodhë në përputhje të plotë me Kushtetutën.

Në anën tjetër, sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e Projektligjit për KPK, duhet theksuar faktin se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqinë ekuivalente me normën kushtetuese. Si të tilla, të njëjtat duhet respektuar nga të gjitha institucionet. Nuk i takon asnjë institucioni, përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë, që të hedhë akuza në drejtim të Gjykatës Kushtetuese për mënyrën e vendimmarrjes.

Por, nisur nga gjetjet e Strategjisë së Sundimit të Ligjit⁶⁴, përbërjes korporatiste të KPK⁶⁵ dhe gjetjeve të IKD mbi dështimin e mekanizmave të brendshëm dhe mungesën e rezultateve të sistemit prokurorial, reforma në sistemin prokurorial mbetet domosdoshmëri. Kështu, i takon Ministrisë së Drejtësisë që pas aktgjykimit të gjykatës kushtetuese, të qartësojë rrugën që do të ndjekë me qëllim të zhvillimit të reformës në sistemin prokurorial, e cila reformë, para së gjithash, duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe gjetjeve të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me këtë ligj.

⁶³ “KPK: Ligji i miratuar në Kuvend cenon rëndë pavarësinë e këtij organi kushtetue”. Betimi për Drejtësi, 23 qershor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-ligji-i-miratuar-ne-kuvend-cenon-rende-pavaresine-e-ketij-organi-kushtetues/>). (Qasur për herë të fundit më 23 shkurt 2023).


⁶⁴ “Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026”. Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks.gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>).

⁶⁵ “OPINION ON THE DRAFT AMENDMENTS TO THE LAW ON THE PROSECUTORIAL COUNCIL”. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION). 13 dhjetor 2021. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)051-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)051-e)). (Qasur për herë të fundit më 27 mars 2023).

12. Sfidat e KPK-së me buxhetin

Buxheti i KPK-së gjatë vitit 2022 ka qenë 17 milion e 144 mijë e 178 euro. Krahasuar me kërkesën buxhetore të KPK-së që ka qenë 21 milion 697 mijë e 194 euro, këtij institucioni i janë ndarë 1 milion 582 mijë e 912 euro më pak. Ky buxhet i ndarë për KPK ka bërë që ky i institucion mos arrij ti përmbush të gjitha obligimet ligjore dhe planifikimet e saj.

Ministria e Financave dhe Kuvendi nuk i kanë përmbushur kërkesat e KPK-së për ndarjen e fondeve për zbatimin e Ligjeve që janë miratuar nga vetë Kuvendi. Me Ligjin për Prokurorin e Shtetit është përcaktuar se për kryerjen e përgjegjësive të tyre çdo prokuror duhet të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional.⁶⁶ Sipas KPK-së gjatë vitit 2022 kanë qenë të punësuar 141 bashkëpunëtorë profesional. Nëse krahasohet me numrin e prokurorëve që deri në fund të vitit 2022 kanë qenë 183 prokurorë, atëherë i bie që 42 prokurorë kanë mbetur pa bashkëpunëtorë profesional.



Grafiku 4: Numri i bashkëpunëtorëve profesional në raport me numrin e prokurorëve.

Është interesante të theksohet se edhe pse ligji i lartcekur parasheh rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional, megjithatë Ministria e Financave dhe as Kuvendi nuk ka dhënë buxhet shtesë për tu zbatuar në tërësi ky ligj, kjo ka pamundësuar që të rritet numri i bashkëpunëtorëve duke ndikuar edhe në efikasitetin e sistemit prokurorial. Lidhur me këtë çështje nga KPK kanë deklaruar se për tu zbatuar obligimi ligjor për bashkëpunëtor profesional kërkesat e tyre buxhetore kanë qenë të ndara për një periudhë tre vjeçare dhe se sipas tyre ky obligim ligjor është paraparë të realizohet në periudhën 2022-2024.⁶⁷

Për këtë arsye, Ministria e Financave duhet të përfshijë këto kërkesa të KPK-së në planifikimet buxhetore e më pas dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet që të miratojë ndarjen e këtyre

⁶⁶ Ligji Nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për prokurorin e shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05/L-034. neni 12B.

⁶⁷ Përgjigje e KPK-së për IKD.28 shkurt 2023.

mjeteve financiare në adresë të KPK-së në mënyrë që të zbatohet në tërësi neni 12B i Ligjit për Prokurorin e Shtetit, pasi siç dihet funksionimi dhe përmbushja e mandatit kushtetues të Këshillit, ndër të tjera varet edhe nga buxheti që këto dy institucione i ndajnë në dispozicion KPK-së.

Ndër sfida tjera të KPK-së lidhur me buxhetin janë theksuar edhe nevojat për rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit, nevoja për rritjen e numrit të mbrojtësve të viktimave dhe domosdoshmëria për rritjen e numrit të prokurorëve për Departamentin për Krime Luftë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV) aktualisht ka një numër prej 18 mbrojtësve të viktimave. Sipas KPK-së për këtë zyre janë kërkuar edhe pesë (5) mbrojtës të viktimave por që nuk është aprovuar asnjë pozitë.⁶⁸ IKD gjatë draftimit të këtij raporti ka kërkuar sqarime nga Ministria e Financave se pse nuk janë aprovuar këto pozita, por se nuk ka marrë përgjigje.

13. (Pa) Barazia Gjinore në Sistemin Prokurorial

Në Kosovë, përfaqësimi i barabartë gjinor nëpër institucione publike kërkohet me Kushtetutë dhe rregullohet me ligje të veçanta, e specifikisht rregullohet me Ligjin për Barazinë Gjinore.⁶⁹

Po ashtu, Ligji për Këshillin Prokurorial ka përcaktuar se KPK do të mbikëqyr kriteret për pranim në prokurori, kriteret këto ku përfshihet edhe barazia gjinore. Madje, sipas këtij ligji anëtarët e Këshillit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës. Mirëpo, në praktikë barazia gjinore në përgjithësi në sistemin prokurorial lë shumë për të dëshiruar, e për më tepër kjo pabarazi është më e theksuar në pozitat udhëheqëse, ku mbi 90% e tyre udhëhiqen nga prokurorët burra.

Në fund të nëntëmuajorit të vitit 2022, numri i përgjithshëm i prokurorëve në Prokurorin e Shtetit ka qenë 183 prokurorë. Nga numri i përgjithshëm i prokurorëve 105 apo 57.38% janë burra dhe 78 apo 42.62% janë gra.⁷⁰ Sipas Raportit të Progresit për vitin 2022, Kosova ende ka një përqindje të ulët të gjyqtarëve dhe prokurorëve femra në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane.⁷¹

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ **Shënim:** Në nenin 6, par 8 të Ligjit për Barazi Gjinore thuhet: “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësorë dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.

⁷⁰ Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit Janar-Shtator 2022.


⁷¹ Raporti i Progresit për Kosovën 2022.

Përqindje pothuajse e ngjashme është edhe sa i përket përbërjes së KPK-së. Nga 11 anëtarë të KPK-së, vetëm tre (3) janë gra. Shprehur në përqindje i bie se 73% e KPK-së përbëhet nga anëtarët burra dhe vetëm 27% e KPK-së përbëhet nga anëtareset gra.

Pabarazia më e theksuar shprehet në pozitat udhëheqëse. Përqindja e grave në pozitat udhëheqëse nuk është ekuivalente me përqindjen e përgjithshme të grave prokurore në sistemin e drejtësisë.

Kjo pasi, nga dhjetë (10) prokurori në vend, pozitën e kryeprokurorëve e mbajnë vetëm prokurorët burra.

Kështu, përballë faktit se 42.62% e sistemit prokurorial përbëhet nga gratë prokurore, vetëm 3% e tyre janë në pozita udhëheqëse. *(Shih grafikun më poshtë).*



NGA **10** PROKURORI NË VEND POZITËN E KRYEPROKURORËVE E MBAJNË VETËM PROKURORËT BURRA.

